



This project is funded
by the European Union



5 Dhjetor 2018

RAPORT I PJESSHËM

PËR MONITORIMIN E NGRITJES SË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (KED)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Korniza e re kushtetuese dhe ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë, ndër të tjera parashikon organizimin dhe funksionimin e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përkatësisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) dhe Shkolla e Magjistraturës.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga miratimi i amendamenteve kushtetuese dhe ligjit organik të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (nr.115/2016), konstatojmë me shqetësim se këto institucione tepër të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të sistemit të drejtësisë nuk janë ngritur ende.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të projektit “*Përfshirja Sociale për një sistem drejtësie funksional dhe të hapur në Shqipëri*”, financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, gjatë periudhës Prill 2018 – Mars 2019 është duke zbatuar nismën “Për të rritur pavarësinë, llogaridhënien, transparencën dhe efikasitetin e Institucioneve të Reja të Qeverisjes të Drejtësisë”.

Në fokus të nismës së KShH-së kanë janë aspekte të ndryshme të ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve si transparenca karshi publikut, meritokracia, pavarësia, përgjegjshmëria, respektimi i procedurave të parashikuara në ligj dhe efikasiteti i tyre, etj.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) është një nga institucionet e rëndësishme të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. KED shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale.

“This document has been produced with the financial assistance of the European Union. The implementation of this project is carried out by SCI in collaboration with Albanian Helsinki Committee. The contents of this document are the sole responsibility of Albanian Helsinki Committee and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the European Union

Problematikat e shfaqura në drejtim të ngritjes në kohë të KED-së kanë reflektuar ndër të tjerash në bllokimin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, e cila po përballet me një numër të lartë vakancash, si rezultat i shkarkimit apo dorëheqjeve të një numri të konsiderueshëm anëtarësh për shkak të vettingut ose siç njihet ndryshe, rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve.

KED përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 221/1, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Përbërja prej 9 anëtarësh e KED-së është: *dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, një gjyqtar i Gjykatës së Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë nga gjykatat e apelit, dy prokurorë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit, një gjyqtar nga gjykatat administrative.* Ata ushtrojnë detyrën me një mandat një vjeçar, që fillon në datën 1 Janar të çdo viti kalendarik. Sipas pikës 3, të nenit 220, dhe sipas pikës 7, të nenit 221, të po të njëjtit ligj, krahas anëtarëve të KED-së, zgjidhen edhe anëtarë zëvendësues të tyre, që zëvendësojnë të parët në rast pamundësie ose të konfliktit të interesit.

Ndër konstatimet më të rëndësishme të këtij raporti monitorues të KShH-së, të analizuara më gjerë në pjesët vijuese të tij, janë si vijon:

a) Vonesat në fillimin e zbatimit të ligjit të vettingut, ritmet jo dinamike nga organet e vettingut në drejtim të rivlerësimit kalimtar me përparësi të anëtarëve të shortuar në KED, moskalimi me sukses i vettingut për pjesën dërrmuese të këtyre anëtarëve apo dorëheqja e tyre si dhe vështirësitë e paraqitura në drejtim të gjetjes së kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj, në mënyrë të veçantë e kriterit të përfundimit të shkollës së magjistraturës, vlerësohen se janë disa nga arsyet që kanë penguar konstituimin me legjitimitet të plotë vendimarrës të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi, konform Kushtetutës dhe ligjit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (nr.115/2016).

b) Shorti për anëtarët e KED është hedhur në mënyrë konseguative për dy vite rrjesht, përkatësisht për anëtarët e KED-së për vitin kalendarik për vitin 2017 dhe për vitin 2018. KED, sipas dokumentacionit të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton të jetë mbledhur në dt.19 Mars 2018, me objekt pune ndër të tjerash, konstituimin e KED-së¹. Më pas, nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë mbledhje kolegjiale e këtij institucioni të ri të drejtësisë. Rrjedhimisht në vlerësimin tonë, KED nuk është konstituar me legjitimitet të plotë, pasi nuk ka mundur të ushtrojë vendimmarrje efektive dhe konkretisht kompetencat e parashikuara në ligjin nr.115/2016, duke ndikuar në bllokimin e procesit të plotësimi të vakancave në Gjykatën Kushtetuese.

c) Organizimi i shortit për anëtarët e KED nuk është realizuar nga Presidenti i RSH, çka ka bërë që sipas ligjit ky short të realizohet nga Kuvendi i RSH, në përputhje me ligjin nr.115/2016. Ndërkohë që në datë 3 dhjetor 2018 me anë të Urdhrit n. 3 “*Per caktimin e datës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm)*” Kyretari i Kuvendit ka vendosur se edhe shorti i tretë për anëtarët e KED-së për vitin 2019 do të organizohet sërisht nga Kuvendi në datë 7 dhjetor 2018.

d) Si për kandidatët e përzgjedhur me short për vitin 2017, edhe për kandidatët e përzgjedhur me short për vitin 2018, rezulton se vetëm 3 prej tyre e kanë kaluar me sukses vettingun, 2 prej të cilëve me vendim të formës së prerë. Pjesa dërrmuese e anëtarëve është

¹http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Mbledhja_e_pare_e_Keshillit_te_Emerimeve_ne_Drejttesi_5024_1.ph

shkarkuar, ndërkohë që një minorancë e tyre është dorëhequr, dhe për 2 prej tyre procesi i vettingut ende nuk ka përfunduar.

e) Institucionet përgjegjëse nuk patur gjithmonë transparencë në faqet e tyre zyrtare, sa i takon publikimit të listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për në KED. Kjo gjetje i referohet të dhënave që duhet të publikohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë për kandidatët anëtarë në KED për vitin 2019. I njëjti konstatim vlen edhe sa i takon shkresës që media referon se është drejtuar nga Presidenti i RSH tek Kuvendi, për ekzistencën ndër të tjerash të një vakumi ligjor në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Ky aspekt dëshmon një problematikë në aksesin në informacionin që duhet të vihet në dispozicion publikut, i cili mund të vihet në dijeni të hapave të ndryshme të insitucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë me anë të shtypit, pa pasur akses direkt në këto informacione në faqët zyrtare të institucioneve.

f) Anëtarët e KED-së qëndrojnë në detyrë për 1 vit nga data 1 janar i çdo viti kalendarik, me përjashtim të anëtarëve të KED që zgjidhen për herë të parë në këtë institucion, të cilët pavarësisht nga momenti i zgjedhjes, sipas nenit 170 të Kushtetutës qëndrojnë në detyrë deri në dt.31 Dhjetor të vitit kur ka hyrë në fuqi ligji për ndryshimet kushtetuese, në kuadër të reformës në drejtësi (në vitin vitin 2016). Megjithatë, duke marrë shkas nga problematikat e hasura deri më tani me krijimin dhe konstituimin me të kompetenca të plota vendimmarrëse të KED-së, vlerësojmë se ligji krijon paqartësi lidhur me momentin kur kandidatët e viteve pasuese do të fitojë legjitimitetin për të qenë anëtar i **KED-së së parë të përkohshme** dhe rrjedhimisht për të vlerësuar momentin e fillimit dhe të mbarimit të mandatit të tij. Kështu, ka ndodhur që anëtarët e shortuar në KED për vitin 2017 janë rivlerësuar nga organet e vettingut në vitin 2018, efektivisht pas më shumë se një viti nga shortimi i tyre. Jo për të gjithë kandidatët e shortuar për vitin 2017, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka cilësuar nëse ata janë ose jo kandidatë në KED, duke ndjekur një praktikë të ndryshme. Shortimi i këtyre kandidatëve nga KPK për t'ju nënshtruar procesit të vettingut është realizuar me anë të njoftimit të dt. 30 Nëntor 2017², një javë para se të hidhej shorti nga Kuvendi i RSH për kandidatët e rinj të KED për vitin 2018.

g) Referuar interpretimit sistematik të neneve 221/3 dhe 284 të ligjit nr.115/2016 ***është e paqartë se kush do të konsiderohet Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë***, nëse do të jetë KED me anëtarët e vitit 2017, të cilët u vetuan me vonesë dhe shumica e tyre nuk arriti ta kalojë vettingun dhe rrjedhimisht kjo KED nuk u konstitua me legjitimitet të plotë për të ushtruar vendimmarrje efektive. Po kështu ndodhi edhe me KED-në me anëtarët e propozuar dhe të përzgjedhur për vitin 2018. Megjithatë, KShH është i mendimit se KED e përkohshme ende nuk është konstituar për herë të parë, për shkak të mosplotësimit të numrit të anëtarëve të rivlerësuar me sukses, të nevojshëm për të arritur kuorumin e kërkuar për të patur mbledhje të vlefshme. Në frymën e Kushtetutës dhe të Ligjit, anëtarët e KED-ve të përzgjedhur me short në vitet 2017 dhe 2018 nuk mund të ushtronin efektivisht vendimmarrjen nëse të paktën 5 anëtarë nuk e kalonin me sukses vettingun. Në të kundërt, do të minohej besueshmëria dhe cilësia e procesit vendimmarrës nëse shumica e këtyre anëtarëve do të shkarkohej nga vettingu.

h) Përcaktimi se kush do të konsiderohet KED e përkohshme ndikon edhe në drejtim të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve. Kjo pasi, ndryshimi midis KED së Përkohshme që krijohet për herë të parë sipas dispozitave tranzitore të Kushtetutës (neni 179) dhe dispozitave tranzitore të ligjit nr.115/2016 (neni 284) nga KED që do të krijohet sipas dispozitave standarte të Kushtetutës dhe të Ligjit është se, ndër të tjerash, anëtarët e KED së përkohshme i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar *ex post* (pas zhvillimit të shortit),

² <http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

ndërkohë që anëtarët e KED-ve që do të konstitohen në mënyrë periodike çdo vit të mëpasshëm, i nënshtrohen verifikimit të plotësisht të kushteve *ex ante* (para zhvillimit të shortit nga Presidenti ose Kuvendi), përkatësisht nga Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorsë. Janë më pas këto institucione që i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet.

i) Qasja institucioneve përgjegjëse për procedurat e propozimit, të shortimit dhe të rivlerësimit me përparësi të kandidatëve apo anëtarëve të KED-së nuk rezulton të jetë e unifikuar sa i takon zbatueshmërisë dhe interpretimit të ligjit nr.115/2016.

j) Nga analiza e dispozitave ligjore, ligjvënëse nuk ka parashikuar se çfarë do të ndodhë kur mungojnë kandidaturat e nevojshme (plotësisht ose pjesërisht) që plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj. Ky aspekt nuk është marrë parasysh nga Kushtetuta dhe nga ligji 115/2016.

k) Në disa raste rezulton se kandidatët janë skualifikuar nga listat për shkak se nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës por ka patur edhe raste sporadike, për kandidatët e shortuar me sukses në KED për vitin 2017 që nuk e plotësojnë këtë kriter.

l) Për vitin 2019, ka një shkallë më të lartë probabiliteti për krijimin e KED, referuar emrave që janë propozuar deri më tani, pasi një pjesë e këtyre anëtarëve rezulton se e kanë kaluar me sukses vettingun me vendim të formës së prerë. Megjithatë, në listën e emrave të propozuar nga institucionet përkatëse, në varësi edhe të rezultateve që do të prodhojë shorti i hedhur nga Kuvendi, sërisht mund të mos sigurohet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje nëse të paktën 5 prej anëtarëve të shortuar nuk e kalojnë në mënyrë të suksesshme rivlerësimin kalimtar me përparësi.

m) Per sa i përket monitorimit të procedurave të zgjedhjes së KED, në përputhje me ligjin nr.115/2016 është ngritur dhe ka filluar funksionimin, Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimi të Ligjit n.115/2016. Ngritja e këtij komisioni sipas nenit 288 të Ligjit nr.115/2016 duhet të ndodhte brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, por ky afat nuk u respektua dhe praktikisht Komisioni është ngritur dhe ka filluar funksionimin e tij, rreth dy vite më vonë. Rrjedhimisht, Komisioni është ende në një fazë të hershme të veprimtarisë së tij dhe nuk ka mundur të zhvillojë një monitorim të plotë e të thellë të ecurisë së krijimit dhe funksionimit të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Komisioni, si një nga aktivitetet fillestare ka përgatitur një raport për gjëndjen aktuale të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi duke konkluduar se KED 2018 është në fakt një KED e përkohshme.

n) KShH i sugjeron organeve të sistemit të drejtësisë dhe në mënyrë të veçantë institucioneve përgjegjëse për propozimin, përzgjedhjen me short dhe rivlerësimin kalimtar të kandidatëve të KED-së të dialogojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive, në respektim të Kushtetutës dhe të Ligjit nr.115/2016, për të gjetur një zgjidhje sa më efektive që do të kontribuojë në drejtim të kapërcimit të ngërçit të krijuar për konstituimin dhe funksionimin e KED-së.

1. ORGANIZIMI I SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KED-SË

Sipas ligjit nr.115/2016, *“Presidenti i Republikës organizon shortin për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të përkohshëm të emërimeve në drejtësi pa vonesë. Procedurat e shortit dokumentohen nga Presidenti i Republikës. Procedurat e shortit zhvillohen në prani të Avokatit të Popullit, i cili harton dhe bën publik një raport monitorimi mbi procedurën e shortit. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të përzgjedhë anëtarët e Këshillit deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit, në prani të Avokatit të Popullit, i përzgjedh ata brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik”.*

Shorti për anëtarët e KED-së është zhvilluar 2 herë nga ana e institucionit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në vënd të hedhjes nga ana e Presidentit të Republikës, në datat 27.01.2017 për anëtarët e KED që do të ushtronin funksionin në vitin 2017 dhe në dt. 07.12.2017, për anëtarët e KED-së që do të ushtronin funksionin në vitin 2018.

A) Shorti për anëtarët e KED që do të ushtronin funksionin në vitin 2017

Në lidhje me shortin e parë, nëpërmjet vendimit nr. 3 datë 24.01.2017 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, Kryetari i Kuvendit ka përcaktuar rregullat e hedhjes së shortit³.

Me njoftim të së njëjtës datë Kryetari i Kuvendit ka vendosur që shorti të hidhet më datë 27 janar 2017.

Në zbatim të pikës 3 të vendimit të mësipërm, me Urdhër nr. 14, datë 24 janar 2017 të Sekretares së Përgjithshme të Kuvendit u ngrit Sekretariati Teknik, i cili organizoi procedurat e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Shorti zyrtar u zhvillua në datën **27 janar 2017**, ora 10:00, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta.

Në perfundim të hedhjes së shortit në zbatim të nenit 284 pika 8, në faqen online të Kuvendit është publikuar “Relacioni për procesin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”⁴ si dhe raporti monitorues i Avokatit të Popullit.

B) Shorti për anëtarët e KED që do të ushtronin funksionin në vitin 2018

Në lidhje me shortin e dytë, Presidenti i Republikës nëpërmjet shkresës nr. 2668 datë 10.11.2017, drejtuar Kryetarit të Kuvendit, me lëndën “Mbi organizimin e shortit për përzgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, e lidh pamundësinë për të organizuar shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit me të drejtën që Kushtetuta i ka njohur Kuvendit për të interpretuar në mënyrë autentike aktin themeltar të shtetit.

Në datën 20.11.2017 Kryetari i Kuvendit i është drejtuar me shkresë zyrtare kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për paraqitjen e listave të kandidatëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi⁵.

³ Fletore Zyrtare nr.8 datë 24.01.2017.

⁴ <https://www.parlament.al/News/Index/5680>

⁵ <http://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/raport%202017.pdf>

Në lidhje me rregullat e hedhjes së shortit, Kryetari i Kuvendit ka nxjerrë Urdhërin nr.1 datë 22.11.2017 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.⁶ Ky urdhër në pikën 22 të tij, ka shfuqizuar Vendimin nr. 3 datë 24.01.2017 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, të Kuvendit.

Në respektim të pikës 3 të nenit 149/d dhe pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 284 të Ligjit nr. 115/2016, më datë **7 Dhjetor 2017** (ora 10:00) është hedhur shorti për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të ushtronin mandatin e tyre gjatë vitit kalendarik 2018.

Hedhja e shortit u zhvillua nën drejtimin e Zv/Kryetares së Kuvendit, në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë⁷, mbi bazën e delegimit të kësaj kompetence nga ana e kryetarit të Kuvendit, me anë të autorizimit nr.2927 datë 23.11.2017.

Në perfundim të hedhjes së shortit në zbatim të nenit 284 pika 8, në faqen online të Kuvendit është publikuar “Relacioni për procesin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”⁸ si dhe raporti monitorues i Avokatit të Popullit.

C) Shorti për anëtarët e KED që do të ushtrojnë funksionin në vitin 2019

Për sa i përket shortit për të përzgjedhur anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2019 edhe një herë shorti do të hidhet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Sipas informacioneve të publikuara në media, nëpërmjet një letre drejtuar Kuvendit, Presidenti i Republikës shpjegon se ka vakum ligjor për këtë procedurë. Burimet mediatike referojnë më tej se, ligji thotë në pikën 3 të nenit 221, të cilës i referohet Presidenti është se kandidatët që plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe më pas ia paraqesin Presidentit janë Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në kushtet kur këto dy këshilla nuk janë ngritur ende, atëherë nuk ka organ që bën verifikimin. Nga ky arsytim, Presidenti refuzon të hedhë shortin dhe kërkojë ndryshimin e ligjit.⁹ Në faqen zyrtare të Presidencës nuk është publikuar asnjë informacion lidhur me këtë çështje ndaj rrjedhimisht nuk ka ende një transparencë nëse ka ose jo vakum ligjor në vlerësimin e Presidentit (nëse po në ç’drejtim).

Në vijim të vendimit të Presidentit të Republikës, në datë 3 dhjetor 2018 Kryetari Kuvendit ka publikuar njoftimin për hedhjen e shortit në datë **7 dhjetor 2018**¹⁰.

Ky vendim është marrë nga Kryetari i Kuvendit me Urdhërin nr.3, datë 3.12.2018 “Për caktimin e datës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm)”¹¹.

⁶Fletore Zyrtare nr.202 datë 22.11.2017

⁷<https://www.parlament.al/News/Index/5322>

⁸<https://www.parlament.al/News/Index/5318>

⁹<http://oranews.tv/article/meta-nuk-hedh-shortin-ked-ia-kalon-kuvendit>

¹⁰<https://www.parlament.al/News/Index/7060>

¹¹<https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/URDHERnr.3dt.03.12.2018.pdf>

Ndërsa rregullat e shortit janë përcaktuar në Urdhrin nr.2, datë 3.12.2018 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm)”¹². Ky urdher në pikën 22 të tij, ka shfuqizuar Urdhërin nr.1 datë 22.11.2017 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, të Kuvendit.

2. PËRZGJEDHJA E ANËTARËVE ME SHORT

Më datë 27.01.2017, përmes një shorti të hedhur në ambientet e Kryesisë së Kuvendit, nga 52 kandidatë janë përzgjedhur 9 anëtarë. Katër institucionet, respektivisht Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme kishin dorëzuar 52 propozimet e tyre. 9 anëtarët e KED-së për vitin 2017 sipas këtij shorti rezultojnë:

- a) **Vladimir Kristo** dhe **Besnik Imeraj** nga Gjykata Kushtetuese, ndërkohë që anëtare zëvendësuese u zgjodh **Altina Xhoxhaj**;
- b) **Mirela Fana** nga Gjykata e Lartë dhe anëtar zëvendësues **Artan Zeneli**;
- c) **Rovena Gashi** nga Prokuroria e Përgjithshme, për të cilën nuk u hodh short pasi ishte i vetmi emër i dërguar dhe nuk kishte asnjë kandidat zëvendësues);
- d) **Brikena Ukperaj (Lubonja)** dhe **Ervin Metalla** nga Gjykata e Apelit;
- e) **Gentian Trenova** dhe **Fatjona Memçaj** nga prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit, nuk u realizua short pasi ishin dërguar 2 emra aq sa ishte numri i vendeve që kërkoheshin nga ky institucion (asnjë kandidat zëvendësues);
- f) **Kastriot Selita** nga Gjykata Administrative.

Më datë 07.12.2017, Kuvendi i Shqipërisë ka hedhur shortin për anëtarët e KED-së për vitin 2018. Rezultatet e këtij shorti për anëtarët e përzgjedhur janë si vijon:

- a) Nga Gjykata Kushtetuese¹³ u zgjodhën 2 anëtarë të përhershëm, përkatësisht **Besnik Imeraj** dhe **Altina Xhoxhaj**, si dhe 1 anëtare zëvendësuese: **Vitore Tusha**.
- b) Nga Gjykata e Lartë¹⁴ u zgjodh **Artan Broci**, ndërsa si anëtar zëvendësues u zgjodh **Shkëlzen Selimi**.
- c) Nga Prokuroria e Përgjithshme, u zgjodh **Rovena Gashi**, pa procedurë me short, pasi ishte e vetmja kandidate e paraqitur nga ky institucion. Për anëtarin zëvendësues të këtij institucioni nuk u hodh shorti, pasi nuk pati kandidatë.
- d) **Gentjan Trenova** dhe **Fatjona Memçaj** u përzgjedhën gjithashtu pa short si të vetmit kandidatë për dy vendet në KED nga prokurorët pranë Gjykatave të Apelit.
- e) Në listë nga Gjykata e Apelit ishin 83 kandidatë ku shorti përzgjodhi **Enton Dhimitrin** dhe **Fatos Qaton**.
- f) Nga Gjykata Administrative ishin 42 kandidatura për një anëtar, ku shorti përzgjodhi **Ahmet Jangullin**.
- g) Shorti përzgjodhi si anëtar zëvendësues nga lista e gjyqtarëve të Apelit dhe Gjykatës Administrative (i cili sipas ligjit është i përbashkët), gjyqtarin **Sotiraj Lubonja**.

Për vitin 2019, shorti do të hidhet nga Kryetari i Kuvendit në datë 7 dhjetor 2018. Në këtë njoftim, në ndryshim nga njoftimi i një viti më parë, i datës 7 dhjetor 2017, nuk bëhen

¹² <https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/URDHERnr.2dt.3.12.2018.pdf>

¹³ Si kandidatë, Gjykata Kushtetuese sillte 6 kandidatë: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo dhe Besnik Ymeraj

¹⁴ U sollën 8 kandidatë nga Gjykata e Lartë: Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Admir Thanza, Tom Ndreca, Artan Broci, Ardian Dvorani dhe Medi Bici

This document has been produced with the financial assistance of the European Union. The implementation of this project is carried out by SCI in collaboration with Albanian Helsinki Committee. The contents of this document are the sole responsibility of Albanian Helsinki Committee and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the European Union

publik emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret, të propozuar nga institucionet përkatëse (Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme).

Kandidatët që plotësojnë kriteret për në KED, janë publikuar në faqet zyrtare të Gjykatës Kushtetuese dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, çka ka mundësuar transparencë karshi publikut. Nuk ka patur transparencë lidhur me këtë çështje në faqen e Gjykatës së Lartë, por informacioni për kandidatin që plotëson kriteret në Gjykatën e Lartë është publikuar në media. Ndërkohë që edhe KLD nuk rezulton të ketë bërë transparencë për kandidatët që plotësojnë kriteret dhe ky informacion nuk rezulton as në media. **Konkretisht:**

- a. **Lista e kandidatëve nga Gjykatës Kushtetuese** - Nga lista e publikuar për kandidatët në radhët e anëtarëve të gjykatës Kushtetuese, figurojnë anëtarët Bashkim Dedja dhe Vitore Tusha. Kandidati Bashkim Dedja është konfirmuar nga KPK, por ky vendim është ankimuar nga KPA. Seanca publike do të zhvillohet në datë 12 dhjetor 2018, pra pas datës në të cilën duhet të hidhet shorti për anëtarët e KED 2019. Ndërsa Vitore Tusha, e cila e ka kaluar me sukses vettingun me vendim të formës së prerë është propozuar nga Presidenti i Republikës si kryetare e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nuk janë prezantuar kandidatë zëvendësues, çka vlerësojmë se është për shkak të vakancave të krijuara në këtë gjykatë.
- b. **Lista e kandidateve nga Prokuroria e Përgjithshme** – Nga lista e kandidatëve të Prokurorisë së Përgjithshme, për vendin e parashikuar për prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme vetëm Arta Marku njoftohet se përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, ndërsa evidentohet se për dy vendet e parashikuara nga ligji për prokurorët nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit, është paraqitur vetëm një kandidaturë, ajo e Fatjona Memçaj. Më tej, nga analiza e listës së kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet, janë përfshirë 15 prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme dhe 22 prokurorë të gjykatave të apelit. Për të gjithë këto kandidatë, kriteri i vetëm i mospërfshirjes është mungesa e përfundimit të Shkollës së Magjistraturës. Nënvizohet gjithashtu se nuk janë prezantuar kandidatë zëvendësues.
- c. **Lista e kandidatëve nga Gjykata e Lartë** - Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë nuk janë publikuar informacione mbi kandidatët e mundshëm, edhe pse ka kaluar tashmë afat i dorëzimit, data 15 nëntor 2018, siç është parashikuar nga ligji (Neni 221/3 Ligji 115/2016). Gjithsesi, krahas mungesës së informacioneve zyrtare, mediat e shtypit njoftojnë se lista e kandidatëve të Gjykatës së Lartë është dorëzuar pranë Presidencës brënda afatit dhe se kandidatet që plotësojnë kushtet janë Ardian Dvorani, Medi Bici dhe Edmond Islamaj. Nënvizohet gjithashtu se nuk ka informacion publik ose nga mediat për prezantimin e kandidatëve zëvendësues.
- d. **Lista e kandidateve nga Këshillit të Lartë të Drejtësisë** - Në faqet zyrtare online të Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në ditën e sotme nuk janë publikuar informacione mbi kandidatet e mundshëm.

3. Rivlerësimi kalimtar (vettingu) i anëtarëve të shortuar

Sipas nenit G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Ndërkohë që sipas nenit 56, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin

‘This document has been produced with the financial assistance of the European Union. The implementation of this project is carried out by SCI in collaboration with Albanian Helsinki Committee. The contents of this document are the sole responsibility of Albanian Helsinki Committee and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the European Union

e procedurës së rivlerësimit. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

Anëtarët e KED-së, njëkohësisht subjekte të rivlerësimit kalimtar, **për të cilët është ndërprerë vettingu si rezultat i dorëheqjes** janë si vijon:

- **Për vitin 2017**

- a) **Besnik Imeraj, Anëtar në Gjykatën Kushtetuese**, i cili ka dhënë dorëheqjen në dt.31.01.2018, pas afatit tre mujor të parashikuar në ligj dhe rrjedhimisht pas periudhës së fillimit të procesit të rivlerësimit ndaj tij. Me vendimin nr 2, datë 31.01.2018 “Me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit në Gjykatën Kushtetuese, të Zoti Besnik Imeraj”, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar mbarimin e mandatit të subjektit të rivlerësimit”. Më datë 08.02.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit, vendim i cili nuk është ankimuar nga Komisioneri Publik dhe për rrjedhojë ka marrë formë të prerë më datë 20.03.2018
- b) **Mirela Fana, Gjyqtare në Gjykatën e Lartë**, ka paraqitur dorëheqjen tek Presidenti i Republikës, në dt. 31.01.2018, pas afatit tre mujor të parashikuar në ligj dhe rrjedhimisht pas periudhës së fillimit të procesit të rivlerësimit ndaj tij. Më datë 23.03.2018 KPK shprehet me vendim për pushimin e procesit të rivlerësimit ndaj gjyqtarës Fana. Ky vendim është ankimuar nga Komisioneri Publik për arsye se KPK nuk ka hetuar dhe analizuar nëse znj. Mirela Fana e ka dhënë dorëheqjen nga funksioni (si anëtare e Gjykatës së Lartë) apo edhe nga statusi i saj si magjistrate/gjyqtare, duke mos vlerësuar nëse për dorëheqjen e magjistratit është formalizuar vendimmarrja e organit kompetent kushtetues, ashtu siç përcakton ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 96/2016). Në mungesë të kësaj vendimmarrjeje, pas dorëheqjes nga mandati si anëtar i Gjykatës së Lartë, magjistrati vazhdon të gëzojë statusin dhe është objekt i veprimit të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës që parashikon nënshtrimin *ex officio* të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në procesin e rivlerësimit. Shkaku i dytë i ankimit lidhet me mos parashikimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës mbi ndalimin e emërimit për 15 vjet të subjektit në pjesën e arsyetimit dhe në bazën ligjore të vendimit të KPK. Arsyeya e tretë lidhet me faktin që Komisioni ka vendosur vetëm mbi bazë dokumentesh, pa zhvilluar një seancë dëgjimore me praninë e subjekteve. Lidhur me këto, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur ndryshimin e vendimit të KPK-së, duke deklaruar se procesi i rivlerësimit ndaj gjyqtarës Mirela Fana ka pushuar.
- c) **Vladimir Kristo, Anëtar në Gjykatën Kushtetuese**, ka dhënë dorëheqjen në dt.31.07.2018, duke njoftuar Presidentin e Republikës, Kuvendin e Shqipërisë dhe Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese. Arsyeya e dorëheqjes vlerësohet se është mbarimi i mandatit të tij si anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Në një njoftim të më të hershëm të Gjykatës Kushtetuese, të muajit Janar 2017, referohet se “Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, pra zëvendësimin e gjyqtarëve të cilëve u ka mbaruar mandati kushtetues, bazuar në nenet 149/d dhe 179/11 të Kushtetutës, në datën 27.01.2017 janë zgjedhur me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, *që do të thotë se automatikisht fillojnë procedurat edhe për zëvendësimin e gjyqtarit Vladimir Kristo*.”

- **Për vitin 2018**

- a) **Besnik Imeraj, Anëtar në Gjykatën Kushtetuese** – është analizuar më sipër.

“This document has been produced with the financial assistance of the European Union. The implementation of this project is carried out by SCI in collaboration with Albanian Helsinki Committee. The contents of this document are the sole responsibility of Albanian Helsinki Committee and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the European Union

Anëtarët e KED-së, njëkohësisht subjekte të rivlerësimit kalimtar, **për të cilët është vendosur shkarkimi nga detyra** në kuadër të vettingut janë si vijon:

- **Për vitin 2017:**

- a) **Altina Xhoxhaj, Anëtare në Gjykatën Kushtetuese** dhe njëkohësisht anëtare zëvendësuese në KED. Në dt.03.05.2018 KPK ka vendosur shkarkimin nga detyra të saj për shkaqe që lidhen me kriterin e pasurisë si dhe nuk është arritur nivel i besueshëm për subjektin e rivlerësimit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Me datë 12.07.2018 është bërë ankimimi në KPA nga vetë subjekti i rivlerësimit. Me datë 24.10.2018 KPA ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KPK për shkarkimin e Gjyqtarës Altina Xhoxhaj. Vendimi ka marrë formë të prerë.
- b) **Artan Zeneli, Gjyqtar në Gjykatën e Lartë** dhe njëkohësisht anëtar zëvendësues KED. Në dt.14.09.2018 KPK ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra për shkaqe që lidhen me kontrollin e figurës dhe pasurisë. Me datë 18.10.2018 është bërë ankimim nga subjekti i rivlerësimit, i cili është në proces pasi ende nuk ka një vendim nga KPA lidhur me këtë ankim.
